



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL

(i përmbledhur)¹

Tiranë, më 09.10.2020, ora 14:10

Drejton mbledhjen

Vitore Tusha – zv/Kryetare e Këshillit

Rendi i Ditës:

1. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.

- Eugen Papandile
- Sonila Bejtja

2. Vendimmarrja lidhur me lejimin/ndalimin e kandidimit të kandidatëve të mësipërm.

Marrin pjesë:

- | | |
|---------------------|---------------|
| 1. Vitore Tusha | (zv/Kryetare) |
| 2. Fiona Papajorgji | (anëtare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Miranda Andoni | (anëtare) |
| 5. Saida Dollani | (anëtare) |
| 6. Fatjona Memcaj | (anëtare) |
| 7. Ludovik Dodaj | (anëtar) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Merr pjesë, si vëzhgues i përhershëm:

1. Avokati i Popullit, përfaqësuar nga z. Enio Haxhimihali.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

- 1. Z. Bledar Dervishaj dhe znj. Katrin Treska,** përfaqësues me autorizim të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.
- 2. Znj. Mimoza Arbi,** përfaqësuese me autorizim e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Vitore Tusha hap mbledhjen dhe bën me dije rendin e ditës që është publikuar në përputhje me procedurat dhe aktet e miratuara nga Këshilli. Verifikon praninë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje. Sqaron se në mbledhjen e mëparshme të datës 05.09.2020, Këshilli për 2 kandidatët që janë objekt për shqyrtim në mbledhjen e sotme, gjatë vendimmarrjes, nuk mori një vendim përfundimtar dhe vlerësoi, bazuar në nenin 50, pika “c”, të vendimit nr. 4/20199 të KED-së, të vijojë hetimin në lidhje me disa kushte dhe kritere për secilin nga këta dy kandidatë. Vijon me miratimin e rendit të ditës, pasi është një element procedural, edhe pse, në fakt, ky rend dite u përcaktua në mbledhjen e mëparshme të Këshillit, ku në fund të saj u vendos thirrja e kësaj mbledhjeje, si dhe u caktua dita, ora dhe çështjet që do të shqyrtoheshin. Fton anëtarët të shprehen.

Anëtarët shprehen se janë dakord me rendin e ditës.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe pyet nëse kandidatëve, të cilët janë shqyrtuar në mbledhjet pararendëse të datës 16 shtator dhe 5 tetor 2020 dhe janë skualifikuar/ndaluar nga kandidimi, a u janë njoftuar vendimet respektive. Kjo për t'u informuar dhe për të pasur një tablo të qartë se në çfarë rrjedhe/gjendje procedurale është çështja e tyre në raport me KED-në dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore, nëse janë hapur të tilla.

Vitore Tusha sqaron se të gjitha vendimet janë mbaruar, dorëzuar në të njëjtën datë dhe komunikimi për 4 vendimet është bërë në të njëjtën kohë. Sipas dëftësive të komunikimit, vendimi i kandidatit Dedë Kasneci është komunikuar në datën 28.09.2020, kurse vendimi i kandidatit Artan Spahiu është komunikuar në datën 26.09.2020. Sipas verifikimit të kryer pranë Gjykatës së Apelit, deri ditën e djeshme në drekë nuk ka pasur asnjë kërkesë ankimore nga këta 2 kandidatë. Për kandidatin e lejuar Altin Binaj dhe kandidatin e tërhequr Gentian Mete nuk është bërë verifikim për momentin e komunikimit, por siç u sqarua në fillim, u është bërë komunikimi në të njëjtën periudhë. Nëse ka interes për datën, mund të pyetet sekretaria. Ndërsa për vendimet e së hënës (datë 5) sqaron se janë duke u përfunduar e duke u kryer korrektimet e fundit dhe shumë shpejt, brenda ditës së hënë, ato do t'u komunikohen kandidatëve.

Vitore Tusha i jep fjalën relatores Miranda Andoni.

Miranda Andoni fillon relatimin dhe sqaron se në zbatim të vendimit të datës 05.10.2020 të Këshillit është komunikuar nëpërmjet postës elektronike me kandidaten Sonila Bejtja për të paraqitur aktet që Këshilli ka vendosur dhe që janë konkretisht akte të paraqitura prej saj, por që figuronin të paraqitura në gjuhën italiane, për të cilat është kërkuar legalizimi i tyre dhe dokumenti i njehsimit të diplomës italiane. Sqaron se prej kandidatës, në datën 06.10.2020, është paraqitur një kopje e legalizuar e diplomës origjinale, e përkthyer në gjuhën shqipe, një kopje origjinale e listës së notave, e noterizuar, si dhe një kopje e vërtetimit të njohjes dhe njehsimit, që mban nr.1045, datë 22.12.2017 të Komisionit të Njohjes së Diplomave pranë Ministrisë së Arsimit. Këto akte janë marrë në dorëzim me procesverbalin e datës 06.10.2020. Relatorja shprehet se duke vlerësuar të kryer edhe këtë detyrë ka përfunduar relacionin, i cili i është bërë me dije edhe kandidatës.

Vitore Tusha sqaron se relacioni është përgatitur në tërësi dhe në të janë evidentuar edhe elementet shtesë të tij në zbatim të vendimit të mbledhjes. Prandaj edhe pyetjet që mund të lindin të jenë në tërësi. Sqaron se Avokatit të Popullit do t'i vihen tani në dijeni aktet që janë kërkuar nga Këshilli dhe që janë përcjellë nga kandidati.

Enio Haxhimihali ndërhyt dhe shprehet se për pikërisht këtë aspekt donte të pyeste, pasi për dy kandidatët rezultoi se kanë sjellë dokumente për të cilat nuk e di nëse i janë vënë në dispozicion Këshillit. Pyet nëse ka pasur një komunikim të Këshillit me kandidatët dhe kandidatët a kanë depozituar dokumente, si dhe nëse janë vënë në dijeni anëtarët e Këshillit për këto dokumente, pra nëse u janë shpërndarë atyre.

Miranda Andoni sqaron se këto akte nuk u janë komunikuar anëtarëve, por përmbajtja e tyre u është bërë me dije anëtarëve nëpërmjet relacionit.

Vitore Tusha sqaron se për përmbajtjen e akteve është debatuar herën e shkuar, por forma u mungonte, pra nëse ishte njohur akti.

Enio Haxhimihali pyet nëse janë dokumente të reja apo kanë qenë dhe i kanë risjellë kandidatët, pasi sipas relacionit rezultoi sikur janë dokumente të reja.

Vitore Tusha sqaron se për kandidaten në fjalë janë të njëjtat dokumente, por në lidhje me formën e paraqitjes së tyre është kërkuar shpjegim, pra nëse diploma është e njohur nga shteti shqiptar. Kandidati e ka sjellë të nesërmen dhe sekretaria është duke e sjellë për ta vënë në dispozicion.

Fatjona Memcaj sqaron se janë njohur me relacionin dhe me faktin e depozitimit. Ato kanë qenë në dosje dhe secili ka pasur aksesin e dosjes.

Vitore Tusha fton relatorin të vijojë me relatimin e gjetjeve në procedurën e kandidatit Eugen Papandile.

Miranda Andoni fillon relatimin dhe sqaron se edhe për këtë kandidat janë në vazhdim procedurat e verifikimit, ku Këshilli në mbledhjen e datës 05.10.2020 ka vendosur të vazhdojë procedurën e verifikimit dhe i është kërkuar kandidatit të shprehë qëndrimin e tij në përmbushje të kërkesave të nenit 125 të Kushtetutës. Sqaron se në datën 07.10.2020 prej kandidatit është paraqitur me shkrim nëpërmjet postës elektronike qëndrimi i tij në lidhje me plotësimin e këtij kriteri dhe lexon të plotë përgjigjen e sjellë nga kandidati. Relatorja sqaron se kjo është e reja e këtij relacioni, i cili pasi është plotësuar edhe me këtë zbatim detyre të lënë nga Këshilli, i është komunikuar kandidatit dhe të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Vitore Tusha parashtrohet përpara Këshillit një shkresë të drejtuar atij, ardhur po atë ditë nga Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, që gjendet në tavolinën e secilit dhe që përmban një opinion për kandidatin Eugen Papandile.

Miranda Andoni lexon të plotë përmbajtjen e opinionit të paraqitur nga Drejtorja Ekzekutive e Grupit Shqiptar të të Drejtave të Njeriut, znj. Elsa Ballauri.

Vitore Tusha sugjeron që të bëhet pjesë e shqyrtimit kjo shkresë dhe pyet nëse anëtarët janë dakord.

Anëtarët shprehen se janë dakord.

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje nga anëtarët për çështjen.

Anëtarët shprehen se nuk kanë pyetje apo sqarime.

Vitore Tusha i jep fjalën përfaqësuesit të Avokatit të Popullit.

Enio Haxhimihali merr fjalën dhe shtron fillimisht në Këshill çështjen për mënyrën e verifikimit të këtyre elementeve: “Ka qëlluar shpesh jo vetëm për këtë kandidat, por edhe kandidatja tjetër për koincidence kanë qenë avokate, por edhe të tjerë më parë, sërish do të vijjnë të tjerë avokatë. Në rastin konkret ishte pak e paqartë për ne, referuar vërtetimit nr.21, datë 06.12.2019 që është administruar në dosje, që tregon se kandidati ka ushtruar profesionin e avokatit pranë Grupit Shqiptar të të Drejtave të

Njeriut në periudhën 1999-2002. Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se në muajin nëntor 2011 kandidati është pajisur me certifikatën e avokatit. Sipas të dhënave të deklaruara në relacion, pika 29, rezulton që ka ushtruar profesionin e avokatit deri në vitin 2003. Pra është pak e paqartë nga këto të dhëna dhe njëkohësisht në relacionin e dytë, atë që na erdhi në mbledhjen e sotme, thuhet që kandidati ka sjellë bashkëlidhur kopje të licencës së avokatit të vitit 2002-2003 dhe kopje të regjistrimit themeltar që ju thashë pak më parë që nuk na janë vënë në dispozicion fotokopjet, por nuk është ky problemi. Ajo që mendojmë të ngremë është mënyra e verifikimit të ushtrimit të profesionit të avokatit. Siç ka rezultuar në dosjet e kandidatëve të tjerë, kryetari i Dhomës së Avokatisë na bën me dije se ka dy lloj avokatësh, pasivë dhe aktivë dhe nisur edhe nga eksperiencia e KPK-së, e cila në rastin e shqyrtimit të gjyqtarëve e prokurorëve të niveleve më të ulëta, këtu bëhet fjalë për kandidatë të Gjykatës Kushtetuese e jo për gjyqtarë të shkallës së parë e të dytë, nuk mjaftohet me vërtetimin, por po themi bën dhe një certifikim me Drejtorinë e Financave përkatëse të rretheve ku ka ushtruar veprimtarinë ky avokat. Pra, në rast se kjo ka dy arsye të rëndësishme, e para njëherë vlen për vjetërsinë, kurse e dyta për besueshmërinë e kandidatit, sepse ka pasur raste kur KPK-ja ka verifikuar që nuk janë paguar tatimet nga një avokat dhe ka thënë që ky person nuk ka besueshmërinë e duhur. Në rastin konkret vërtetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë për kandidatin Papandile është, më lejoni të citoj: “shtetasi E.Papandile rezulton i regjistruar për përgjegjësinë tatimore individuale të të ardhurave (diva) nga ana e këtij shtetasi nuk është dorëzuar asnjë deklaratë individuale”. Ky shtetas ka detyrime të pashlyera në vlerën 10 mijë lekë bashkëlidhur vërtetimi i detyrimeve në kohë reale dhe pastaj ka edhe për bashkëshorten. Gjithashtu, edhe nga dokumentacioni që na është vënë në dispozicion për këtë kandidat, nuk rezultojnë të dhëna për këtë periudhë. Në Drejtorinë Rajonale Tatimore rezulton që është regjistruar në vitin 2018. Pra për periudhën që kandidati ka qenë avokat, nuk ka të dhëna nëse janë paguar ose jo tatimet dhe ne prandaj i rekomandojmë Këshillit që të njëjtën praktikë që ka ndjekur KPK-ja të ndiqet edhe nga KED-ja. Të bëhet një verifikim ndërmjet vërtetimit që vjen nga Dhoma e Avokatisë dhe vërtetimeve të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, nëse janë paguar apo jo tatimet nga kandidati. Kjo për sa i përket pjesës së tatimeve.”

Vitore Tusha kërkon sqarim nëse ky ishte sugjerim apo pyetje.

Enio Haxhimihali sqaron se është pyetje për kandidatin dhe sugjerim në parim, pasi bëhet fjalë për dy kandidatët e sotëm, për ata që janë shqyrtuar më parë dhe për kandidatët e tjerë në vijim që do të kenë eksperiencën si avokat.

Shprehet se: “pika 39 e vendimit nr. 4 do të thotë që Avokati i Popullit mund të parashtrojë mendime dhe vlerësime vetëm në lidhje me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit. Pra ne nuk ndërhyjmë në pjesën e vlerësimit, por me çështjet e procedurave dhe rekomandojmë që në procedura të tilla, pra kur kandidati në CV e tij thotë që ka punuar si avokat, duhet bërë një verifikim paralel edhe me tatimet. Pra, në se ky avokat i ka paguar tatimet apo jo dhe kjo shërben për dy qëllime: për vjetërsinë, por njëkohësisht edhe për besueshmërinë e kandidatit. Kjo ishte vetëm për sa i përket po e quajmë çështjes së avokatisë, të vjetërsisë apo procedurës së verifikimit për të tilla raste.

Nëse më lejohet, meqenëse e mora fjalën, ka edhe një procedurë tjetër verifikimi parimore që prapë mund të ndiqet nga KED-ja. Rezulton që ka kandidatë që kanë jetuar një periudhë kohe jashtë shtetit. Në këto raste në kërkesën që i drejtohet Prokurorisë së Përgjithshme nuk specifikohet që duhen kërkuar të dhëna për periudhën që kandidati ka jetuar jashtë shtetit, edhe kur bëhet fjalë për periudha të gjata, pavarësisht se mund të jenë të shtrira në një periudhë të largët kohore. Mbase në vlerësimin e Këshillit mund të kërkohej nga Prokuroria në mënyrë specifike, sepse kur kemi biseduar në Prokurorinë e Përgjithshme, na është thënë p.sh. që për kandidatët për kryetar bashkie kërkohej në mënyrë specifike që të bëhet një verifikim i tillë. Ata nuk e bëjnë kur nuk u kërkohej një gjë e tillë dhe nga praktika kemi

parë, jo në rastin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, por në rastin e një ish-kandidati për kryetar Bashkie, apo të një ish-gjyqtari të Gjykatës së Lartë, që pavarësisht se ka pasur periudha të largëta, p.sh. kur ish-kandidati për kryetar i Bashkisë kishte qenë student, përsëri në dosjen e tyre penale në shtetin përkatës, kishte rekorde që ata kishin bërë veprimtari për të cilat ishin ndëshkuar ligjërisht. Pra, nëse ju mendoni që periudha ka qenë e gjatë dhe për një periudhë të tillë ka nevojë, kjo mund të bëhet në një kohë të dytë, sepse ndoshta kjo do të vononte procesin, por, nga ana tjetër, verifikimi duhet bërë i plotë, si për periudhën që ka qenë në Shqipëri, ashtu edhe për periudhën jashtë shtetit.

Nëse më lejoni edhe diçka tjetër, një nga problematikat që ne hasim është edhe ngarkesa që ka pasur KED-ja 2019-ës dhe e 2020-ës. Pra, çështje të tilla, në rast se do të kishte, Gjykata Kushtetuese do të funksiononte normalisht, do të ishte e plotësuar, do të vinin 1 ose 2 kandidatë, por në kushtet kur gjykatat i kemi ato që i kemi, puna e KED-së e 2019-ës, që miratoi edhe aktet normative të funksionit, dhe e 2020-ës ka qenë e mbingarkuar dhe e mirëkuptojmë plotësisht relatorin, i cili ka pasur 6 dosje, vetëm një dosje ka qindra e mijëra faqe së bashku me dokumentet e ILDKPI-së dhe është e pamundur për relatorin, i cili është i jashtëm. Pra, kjo është edhe veçoria dhe këtu më lejoni të bëj një parantezë: ne shpesh e kemi ngritur këtë gjë për vlerësimin e anëtarëve të KED-së, pra për ngarkesën më të pakët që ata duhet të kenë dhe shpërblimin për këtë punë që po bëjnë.

Duke qenë se kjo është çështje tjetër, mbase mund të bëhet një mbledhje e veçantë, në një moment tjetër. Unë doja të ndalesha te një moment i rëndësishëm, te puna që bën stafi teknik i KED-së, këshilltarët.

Të gjitha këto pikëpyetje që ngremë, janë bërë apo s'janë bërë këto verifikime, apo edhe kjo mbledhje që bëhet sot në një farë mënyrë është një punë, mbase jo në nivelin e duhur të këshilltarëve dhe më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj një mbledhje të datës 03.02.2020 të këtij Këshilli, ku në rendin e ditës në pikën 5 u miratua ngritja e një grupi pune për hartimin e rregullores së brendshme lidhur me detyrat e këshilltarëve, personelit administrativ për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, për veprime të ndryshme, mbajtjen e dokumentacionit, regjistrin protokollit etj., bëhet fjalë për datën 03.02.2020. Jo më larg se mbledhja e kaluar, pika e parë e rendit të ditës ishte eficienta e këtij Këshilli. Pra, shqetësimi që ngremë, a është në nivelin e duhur të punës administrata e KED-së, sepse jemi në muajin tetor dhe kjo rregullore ne nuk na ka ardhur ende, nuk e dimë në çfarë faze është, mbase dhe pandemia, por në vlerësimin tonë nuk do ta pengonte, sepse është një punë që mund të bëhet edhe nga shtëpia, nuk ishte nevoja të bëhen mbledhje në salla me sekrete e të tjera, nëse do të kishte një kontroll të mirë mbase nuk do të ishim në këtë gjendje të akteve. Pra, roli në vlerësimin tonë i këshilltarëve është mjaft i rëndësishëm dhe do të duhet që puna e tyre të kontrollohet dhe mbase të jetë në një nivel më të mirë, sepse kjo do të sillte sigurisht një lehtësim të madh për relatorin. Kjo ishte pika e tretë që doja të ndalesha, nuk ka lidhje me kandidatin vetëm, por është diçka e përgjithshme”.

Vitore Tusha kërkon nga përfaqësuesi i Avokatit të Popullit që çështjet që kanë natyrë parimore të prezantohen në fillim dhe të mos i atashohen një kandidati, në mënyrë që Këshilli t'i vlerësojë në tërësi në formën e rekomandimeve të paraqitura.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe duke marrë spunto nga disa çështje parimore që ngriti përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, shprehet se verifikimi i të dhënave të kandidatëve për faktin e pagimit të taksave/tatimeve, duhet të jetë pjesë e raportit të ILDKPKI-së, i cili kujdeset shumë qartë dhe është kujdesur “shumë qartë” në disa raste të shqyrtimit në themel të disa detajeve. Në disa raste verifikimi ka shkuar deri në vitin 2003. Mbjaj mend rastin e shqyrtimit të kandidatëve për Inspektorë të Lartë të Drejtësisë, ku raporti i verifikimit në disa raste ka shkuar në detaje. Gjithsesi kjo vakancë e rishpallur nga Presidenti ka pasur fillimisht 10 kandidatë që kanë shprehur interesin. Nga këta, në mbledhjen e parë të Këshillit (16.09.2020) janë ndaluar nga kandidimi 2 (dy) kandidatë, 1 (një) kandidat është kualifikuar që është z. A. Binaj dhe një kandidat tjetër (z. G. Mete) është tërhequr nga kandidimi.

Ngelën dhe 6 kandidatura të tjera për verifikim. Nga këto kandidatura në mbledhjen e radhës (05.10.2020) janë ndaluar nga kandidimi dhe z. Sh. Hasani, z. S. Tafaj, z. S. Mazreku dhe znj. Zh. Peto. Tashmë në garë kanë ngelur vetëm 2 (dy) kandidatura, ndërkohë që me vendim të Këshillit deri tani kemi vetëm një kandidaturë të kualifikuar z. Binaj dhe dy kandidatura në proces shqyrtimi z. Papandile dhe znj. Bejtja. Sqaron se në hyrje të kësaj mbledhje jo më kot pyeti për një informacion se si kanë ecur procedurat e njoftimit të kandidaturave të ndaluara që lidhen me ecurinë e proceseve gjyqësore pikërisht për të mbajtur një qëndrim nga fillim në fund. Në këtë situatë, si institucion mbeten në pritje të një numri të mjaftueshëm të kandidaturave për të realizuar emërimin për plotësimin e kësaj vakance. Ajo që mirëpresin është një numër i mjaftueshëm kandidaturash në mënyrë që Presidenti të ushtrojë të drejtën e zgjedhjes, për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, çka është edhe shqetësimi i vetëm.

Mimoza Arbi merr fjalën dhe shprehet se nisur nga shqetësimi që ngriti përfaqësuesi i Avokatit të Popullit mendoj se verifikimin e zbatimit të ligjit nr. 138 që lidhet me kandidatët që zgjidhen në Gjykatën Kushtetuese e bën Prokuroria. Prokuroria bën verifikimin dhe dërgon konfirmin në KED. Në momentin që kandidati zgjidhet është përsëri organi i prokurorisë që e ka detyrë ta verifikojë për periudhën që kandidati ka deklaruar se ka jetuar për një kohë të gjatë jashtë shtetit kur merr informacion se nuk ka deklaruar një fakt të cilin duhet ta deklaronte sipas ligjit nr.138/2015. Ka një drejtori përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme dhe kjo procedurë kryhet edhe në rastin e zgjedhjes së deputetëve, ku KQZ-ja bën verifikimet duke iu referuar deklaratave të deputetëve. Më pas ka ndodhur që deputetet nuk kanë bërë deklarinimin e saktë bazuar në vendimin 17 të Kuvendit dhe në bazë të konstatimit që bën prokuroria, KQZ i ka hequr mandatin e deputetit. E njëjta gjë mund të ndodhi dhe në rastin e një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese.

Vitore Tusha deklaroi mbylljen e mbledhjes për të vijuar me pikën tjetër të rendit të ditës, procedurën e vendimmarrjes për kandidatët.

Mbyllet mbledhja në orën 14:52.

Tiranë, më 09.10.2020

SEKRETARE

ZËVENDËSKRYETARE

Vilma DOKUSHI

Vitore TUSHA